



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr.  
Nr. Dok.

Prot.

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2021

**Lënda:** *Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të pacientëve në Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë.*

**Drejtuar:** **Zj. Mirela CAMI**  
*Drejtoreshë e Përgjithshme e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor*

**TIRANË**

**Z. Kujtim LLAPI**  
*Drejtor i Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor*

**VLORE**

**Zj. Olta GANAJ**  
*Drejtoreshë e Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë*

**VLORE**

*Të nderuar,*

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar<sup>1</sup>, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, inspektoi Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, më datë 3.12.2020, sipas Planit të Inspektimit për vitin 2020 të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Ermonela Xhafa, me detyrë Komisionere e Mekanizmit Kombëtar, znj. Lindita Xhillari, znj. Gloria Çarkaxhiu dhe z. Besnik Deda me detyrë ndihmës komisionerë të institucionit të Avokatit të Popullit.

Inspektimi pati për objekt mbledhjen e informacionit lidhur me kushtet dhe trajtimin e pacientëve, si dhe identifikimin e rasteve të përdorimit ndaj kësaj kategorie të presionit psikologjik dhe të forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative.

Pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, Institucioni i Avokatit të Popullit ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrorë gjetjet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

***Shënime paraprahe***

<sup>1</sup> Neni 81 i ligjit nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

Kjo ishte vizita periodike monitoruese e MKPT-së në Shërbimin e Psikiatrisë “Ali Mihali”, Vlorë për vitin 2020. Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues zhvilloi takimin paraprak dhe mori një informacion të përgjithshëm nga Nëndrejtoresha Ekonomike znj.Loreta Balaj dhe Përgjegjësjë e Burimeve Njerëzore znj. Irma Sula, pasi drejtuesja e institucionit znj.Olta Ganaj dhe nëndrejtori teknik z.Stiljano Lepuri kishin rezultuar pozitiv me Covid-19 dhe ishin duke marrë mjekimin.

Më tej, grupi i inspektimit vizitoi ambientet e këtij spitali. Nga inspektimi në vend, kontakti me stafin dhe pacientët, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, objekteve, pajisjeve dhe mjediseve, grupi inspektues grumbulloi informacion në lidhje me të drejtat, kushtet dhe trajtimin e pacientëve në këtë spital, respektimin e të drejtave të tyre, si dhe me problematikat e ndeshura gjatë punës.

Struktura dhe organika e institucionit ishte e përbërë nga 128 punonjës, prej të cilëve 93 punonjës në përbërje të ekipit multidisiplinar, (mjek psikiatër 6, psikolog 5, punonjës social 8, infermier 43, kujdestar 31) të ndarë sipas pavijoneve, Shtëpive të Mbështetura Nr.1-2-3 dhe Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor (Q.K.M.SH.) si dhe 35 punonjës ishin staf mbështetës. Në momentin e inspektimit, grupi i punës së konstatoi se mungonte në strukturë një mjek psikiatër, për arsye se mjeku qw kishte qenw i punwsuar ishte në proces gjyqësor me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale pasi nuk i ishte përmbajtur kushteve të kontratës 2-vjeçare të lidhur me këtë institucion duke kërkuar prishjen e saj. Nga ana e institucionit ishte paraqitur kërkesë drejt Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (O.SH.K.SH.) dhe deri më tani kishte qenë i pamundur plotësimi i këtij vendi vakant, pasi nuk kishte shprehur interes asnjë person. Megjithatë nga ana e institucionit pritej me padurim plotësimi i këtij vendi vakant, i cili pritej të plotësohej me diplomimin specializantëve tw parë që do të diplomohen.

Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë përbëhej nga 4 pavijone dhe shtëpitë e mbështetura nr.1-2-3, me kapacitet zyrtar prej 200 pacientësh. Më konkretisht, Pavijoni i Pranim-Urgjencës me 9 shtretër, Pavijoni Akut –Sub-Akut (Burra-Gra) me 34 shtretër, Pavijoni Kronik-Gra me 53 shtretër, Pavijoni Kronik-Burra me 43 shtretër dhe Shtëpitë e Mbështetura nr.1-2-3 me 31 shtretër.

Në momentin e inspektimit, në spital ndodheshin 144 pacientë të shtruar, nga të cilët 142 pacientë ndodheshin të ndarë sipas pavijoneve dhe 2 pacientë ndodheshin në ambientin e observacionit.

Infrastruktura e re e spitalit mundësonte kushte dinjitoze trajtimi për çdo person me probleme të shëndetit mendor që paraqitej në urgjencën e spitalit dhe vizitat mjekësore kryheshin konform ligjit 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, të ndryshuar. Ambientet, kushtet materiale, hapsira jetike për pacient, si dhe shërbimi që ofrohej në pavijonin e pranimit, urgjencës dhe ato akut dhe sub-akut për gra dhe burra ishin në përputhje me standardet.

Sistemi i ankimimit ishte në funksion edhe në rastin e kërkesave/ankesave nga grupe interesi si p.sh., shoqata apo grupime të tjera vullnetare të pacientëve, familjarë ose persona të interesuar për mbrojtjen e interesave të personave me çrregullime të shëndetit mendor. Pasi njiheshin me kërkesë/ankesën personi i ngarkuar i spitalit mblidhte të gjithë informacionin e nevojshëm (kartela, shtrime, observacione), dhe më pas gjykonte nga ana mjekësore duke u konsultuar me stafin mjekësor kthente përgjigjen që në shumicën e rasteve nënkuptonte zgjidhjen e këtij pretendimi. Drejtuesit e institucionit na informuan

se ata i ndiqnin dhe më tej rastet e kërkesë/ankesave pas kthimit të përgjigjes përgjigja në rrugë zyrtare, stafi i spitalit kontaktonte në telefon me personat përgjegjës për t'i sqaruar dhe më tej.

Grupi inspektimit, gjatë vizitës kërkoi të informohet në veçanti edhe mbi masat e marra nga ana e këtij institucioni, për parandalimin e sëmundjes infektive Covid-19<sup>2</sup>. Nga informacioni i mbledhur dhe nga këqyrja në ambientet e këtij spitali rezultoi se është zbatuar protokollin shtesë i shëndetësisë për masat anti-Covid-19, në kuadrin e pandemisë si më poshtë:

- Çdo ditë, stafit të institucionit i ushtrohet kontrolli për matjen e temperaturës para hyrjes në institucion, si dhe pajiseshin me maska dhe doreza.
- I gjithë personeli zbatonte me korrektesë masat mbrojtëse dhe dezinfektuese, duke pasur një vëmendje të shtuar në ambientet e punës me mbajtjen e maskave, përdorimin e dezinfektantëve që ndodheshin në ambientet e përbashkëta por dhe duke ruajtur distancimin social dhe higjienën personale.
- Ishin shmangur ose minimizuar grumbullimet e stafit, mbledhjet dhe kontaktet me të tretë.
- Urdhrat, udhëzimet dhe protokollet shtesë të Ministrisë së Shëndetësisë, ishin afishuar në hyrje të institucionit, si dhe në hyrje të çdo pavijoni.
- Për rastet e punonjësve, kur kanë rezultuar pozitiv janë karantinuar menjëherë në banesat e tyre, si dhe personat e kontaktit të afërt me ta janë larguar nga puna për periudhën e karantinimit, duke shmangur çdo mundësi të përhapjes së mëtejshme të infektimit. Në çdo rast të identifikuar është bërë dezinfektimi në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë.
- Dezinfektimi kryhej në mënyrë periodike në të gjitha ambientet e brendshme dhe të jashtme të institucionit, ndërkohë që çdo të premtë bëhej dezinfektimi nga Bashkia e Vlorës.
- E rëndësishme është për t'u theksuar se që në fillim të pandemisë nuk janë ndërprerë takimet me familjarë, por ato janë lejuar vetëm në distancë në oborrin e spitalit dhe nën mbikëqyrjen e stafit të spitalit. Pacientëve iu është mundësuar komunikimi i shpeshtë me familjarët nëpërmjet telefonit.

Nga sa më lart, u konstatua se rekomandimet e bëra nga Avokati i Popullit, sa i përket përmirësimit të kushteve të jetesës në pavijonet ku mbaheshin të sëmurët kronikë, nuk kishin gjetur zbatim tërësisht, për mungesë të akordimit të fondeve për këtë qëllim nga autoritetet përkatëse. Konkretisht situata paraqitej si më poshtë:

Nga informacioni, rezultoi se kishin gjetur zbatim rekomandimet e Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm:

1. Ishin marrë masa për ofrimin e shërbimit të specializuar me hospitalizim pranë spitaleve rajonale të personave abuzues me substancat narkotike apo/dhe alkoolin, pasi marrin konsultën psikiatrike për çrregullime që shkaktojnë marrja e substancave si dhe duke krijuar ambient të veçantë brenda kapaciteteve ekzistuese në spitalin psikiatrik "Ali Mihali", Vlorë, përkatësisht në një nga dhomat e observimit në Pavijonin e Pranim-Urgjencës kur është i nevojshëm hospitalizimi sipas kritereve të përcaktuara të shëndetit mendor.

---

<sup>2</sup> "Akte ligjore për COVID-19" (Përditësuar datë 30.12.2020 FZ Nr. 234)  
<https://qbz.gov.al/news/33b00e4f-8efb-4c99-8c45-595cd9b84f1b>

2. Ishin marrë masa nga autoritetet përgjegjëse për sigurimin e të gjithë medikamenteve të domosdoshme për ofrimin e një shërbimi cilësor në këtë spital.

Ndërkohë, nuk kishin gjetur zbatim rekomandimet e Avokatit të Popullit:

1. Për marrjen e masave të menjëhershme për t'i dhënë zgjidhje problemit të trajtimit si rezidentë të personave me aftësi të kufizuar intelektuale në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.
2. Për marrjen e masave të menjëhershme lidhur me rikonstruksionin për përmirësimin e kushteve të jetesës në godinën e vjetër, eliminimin e lagështirës në dhoma, dhe zëvendësimin e pajisjeve hidrosanitare dushe e tualete, në mënyrë që të ofrohet një trajtim sa më dinjitoz të personave që trajtohen në këtë spital.
3. Për marrjen e masave për pajisjen e spitalit me rripa të kufizimit fizik dhe këmisha force si një domosdoshmëri për trajtimin me dinjitet të pacientëve.
4. Për marrjen e masave për trajnimin e stafëve mbështetëse për përdorimin e mjeteve fizike konform standardeve të parashikuara në Paketën e Akteve Nënligjore të ligjit Nr. 44/2012 "Për Shëndetin Mendor", dhjetor 2013 pika 1.1, si dhe përmirësimin e kushteve aktuale për izolimin e pacientëve me kriza akute.

Ligji për shëndetin mendor, në nenin 31 të tij, përcakton procedurat e monitorimit të jashtëm të shërbimit të shëndetit mendor nga Avokati i Popullit, nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin Çnjerëzor dhe Poshtëruës, që vepron si strukturë e veçantë nën autoritetin e tij. Ligji garanton vëzhgimin e rregullt me anë të inspektimeve periodike, për të respektuar të drejtat dhe standardet që u ofrohen personave me çrregullime të shëndetit mendor në mjediset e shërbimit të shëndetit mendor të specializuar me shtretër, si dhe paraqet rekomandime në organet përkatëse, me qëllim përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të pacientëve dhe sigurimin e respektimit të plotë të të drejtave të njeriut në institucionet e kujdesit të shëndetit mendor.

Diktuar nga një numër në rritje i sëmundjeve/çrregullimeve mendore, i tipologjive, i grup moshave, i shtrirjes gjeografike, çrregullimeve për shkak të përdorimit të substancave narkotike, etj., lind domosdoshmëri ndryshimi dhe përmirësimi i mbrojtjes dhe kujdesit të pacientëve në kushte të tilla komplekse/ të vështira. Praktika botërore i mëshon politikave lehtësuese dhe mbështetëse për shërbimet e shëndetit mendor, duke vendosur prioritete strategjike që lidhen me trajtimin, ndjekjen, trajtimin spitalor të këtyre pacientëve (shërbimet e shëndetit mendor) në krahasim me shërbimet e kujdesit shëndetësor në tërësi. Për këtë ndërhyrje të rëndësishme, strukturat qeverisëse duhet të krijojnë hapësira për zgjerimin e mbështetjes dhe garantimit të prioriteteve ndaj këtij shërbimi mjekësor për të garantuar mirëfunksionimin e çdo strukture apo specialiteti.

### ***Konteksti dhe kuadri ligjor e institucional***

Shërbimi shëndetësor në Shqipëri është rregulluar me ligjin nr. 10107, datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili përcakton parimet kryesore dhe kuadrin ligjor për rregullimin, organizimin dhe funksionimin e sistemit të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë. Ndërkohë që shërbimi i shëndetit mendor në Shqipëri është rregulluar me ligj të posaçëm që në vitin 1996, përkatësisht me ligjin nr. 8092, datë 21.03.1996, "Për shëndetin mendor", i cili më pas u shfuqizua me ligjin nr. 44/2012 "Për shëndetin mendor", i ndryshuar, që synonte përmirësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e kësaj kategorie. Ky ligj solli nevojën e

reformave në lidhje me ngritjen dhe zhvillimin në shkallë kombëtare të kujdesit komunitar të shëndetit mendor si e vetmja mënyrë për të arritur shërbime komunitare të shëndetit mendor për të gjithë (përfshi deinstitutionalizimin të personave që vuajnë sëmundje të shëndetit mendor, monitorimin e të drejtave dhe lirive themelore nga mekanizma të jashtëm, pjesëmarrjen aktive të aktorëve të shoqërisë civile, etj).

Në konceptin e gjithëpërfshirjes, kuadri ligjor dhe institucional ofron mundësinë e një sistemi të integruar të shërbimeve të shëndetit mendor, i cili nënkupton një rrjet shërbimesh në nivel rajonal.

### ***Kushtet materiale dhe trajtimi i pacientëve.***

Godina e spitalit të ri ishte ndërtuar në vitin 2015, me gjithë infrastrukturën e brendshme të rikonstruktuar. Gjithashtu, ishte instaluar sistem i ri i monitorimit me kamera, si dhe sistemi qendror i ngrohjes/ftohjes, i cili ishte në funksion të plotë. Mirëpo edhe pse një godinë relativisht e re në katin e nëndheshëm kishte probleme lagështire. Ndërkohë që dhe ashensori nuk ishte në punë nga këqyrja në ditën e inspektimit. Gjithashtu sjellim në vëmendje se edhe dushet nuk ishin të gjitha funksionale si në pavijonin Akut –Sub-Akut (burra-gra) ashtu edhe në Pavijonin e Pranim-Urgjencës. Edhe televizorët ishin jashtë funksioni, pasi ata ishin dëmtuar nga pacientët.

Ndërkohë, në pavijonet e pacientëve me çrregullime kronike si rrjedhojë e mungesës së investimeve, godinat ishin të amortizuara dhe në gjendje jo të mirë teknike. Fillimisht, Drejtoria e Institucionit kishte realizuar projektin e rikonstruksionit për të dyja godinat e pavijoneve të kronikëve burra dhe gra, të cilin e kishte paraqitur pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet shkresës datë 26.07.2018, për t'u përfshirë në projekt buxhetin e vitit 2019. Më pas, i njëjti projekt ishte paraqitur në rrugë zyrtare edhe gjatë parashikimit të preventivave në planifikimin e buxheteve të viteve 2019, 2020 dhe 2021. Por, në momentin e inspektimit, institucioni ende nuk kishte një përgjigje nga ana e Ministrisë, por mbeteshin në pritje të investimit për rikonstruksion të këtyre godinave. Nuk ishin siguruar fondet buxhetore për rikonstruksionin e godinave të vjetra, pavarësisht se projektet kishin përfunduar, pritej miratimi i fondeve nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Gjendja në 2 pavijonet e pacientëve kronikë të vendosur si rezidentë në këtë institucion, nuk kishte asnjë ndryshim dhe vazhdonte të mos paraqitej e mirë. Në këto godina, nuk respektohej hapësira jetike dhe kishte lagështirë. Këto salla mbanin deri në 10 pacientë në pavijonin kronik-burra dhe deri në 6 dhe me pak pacientë në pavijonin kronik-gra. Dhomat ku ishin vendosur këta pacientë kishin dritare të mëdha që siguronin ndriçim natyral, por ngrohja për ta ishte e pamjaftueshme. Materialet e buta (dyshekët, çarçafët, batanijet, jastëk, veshmbathjet, kostumet e pacientëve) ishin të siguruar nga operatori ekonomik privat “AGS” sipas nevojave dhe kërkesave të institucionit të përshtatshme për çdo stinë të vitit. Tualetet e dushet, duke patur parasysh gjendjen e godinave ishin të kompletuara me pajisje hidrosanitare, të zëvendësuara me fondet e institucionit sipas nevojave.

- Në spital ishin duke u trajtuar 40 persona me aftësi të kufizuar intelektuale, 53 paciente gra dhe 43 pacientë burra. Ditën e monitorimit ishin edhe 31 pacientë në shtëpitë e mbrojtura. Ekipi multidisiplinar punonte rast pas rasti për të realizuar daljet e pacientëve kronik aty ku ka një bërthamë familjare, në bashkëpunim dhe me institucionet e shërbimeve sociale dhe bashkitë përkatëse.

- Shtrimet e pavullnetshme kryheshin në përputhje me nenin 20 të ligjit Nr. 44/2012, “Për Shëndetin Mendor” të ndryshuar. Procedurat ndiqeshin në mënyrë rigorozë nga stafi i mjekëve të këtij spitali në të gjitha hallkat e tij, dhe plotësimi i dokumentacionit përkatës bëhej në kohë.
- Dhoma e izolimit kishte nevoja për rregullime për shkak të dëmtimeve që kishte pësuar nga të sëmurët e axhituar, edhe pse ishte realizuar rikonstruksioni për vitin 2019 nga fondi mirëmbajtjes. Aktualisht ishte hedhur në sistem të APP-së për një rikonstruksion të dytë duke u bazuar në standardet e kërkuara sipas gjithë tipologjisë së spitalit Psikiatrik. Në këtë institucion spitalor mungonin mjetet e parashikuara të kufizimit fizik (rripat e lëkurës), ndërkohë që ky spital ishte i pajisur me këmisha force te cilat në momentin e inspektimit ishin jashtë përdorimi. Grupi i argumentimit ishte duke mbyllur procedurat me specifikime teknike më të avancuara për blerjen e tyre. Ushqimi sigurohej me katering nga shërbimi privat i kuzhinës. Kuzhinierët dhe punonjësit që shpërndanin ushqimin, ishin të pajisur me librezën shëndetësore të higjienës. Kampionët ushqimorë ruheshin sipas rregullave në frigorifer konstatuar kjo në momentin e inspektimit. Ushqimi ishte cilësor dhe nuk kishte raste të refuzimit të tij.
- Furnizimi me ujë ishte pa probleme dhe plotësonte nevojat e përditshme.
- Autoambulanca ishte në funksion të plotë dhe në ndihmë të stafit kishte edhe një furgon, i cili shërbente për aktivitetet që zhvillonte stafi psiko-social me pacientët jashtë institucionit, të cilat për shkak të situatës së pandemisë janë ndërprerë për momentin.
- Organika e shërbimi psiko-social ishte e plotësuar. Kishte një mirë organizim dhe ndarje të punës ndërmjet punonjësve, si dhe një bashkëpunim e bashkërendim të mirë me stafin mjekësor, konstatuar nga intervistat e kryera me disa prej këtyre punonjësve.
- Ambientet e përbashkëta, për zhvillimin e aktiviteteve apo terapive në grup nga ana e stafit psiko-social, ishin të bollshme, të rregullta dhe në përgjithësi të mirëmbajtura megjithë disa dëmtime të shkaktuara gjatë përdorimit. Punonjësit e shërbimit psiko-social punonin mbi bazën e një plani fillestar që në shtrim dhe më pas pacientët ndiqeshin me këshillime individuale e në grup, psiko-edukim dhe në fund kishte një plan daljeje për secilin prej tyre. Ndërsa sa i përket pacientëve kronikë shërbimi i këtij stafi përqendrohej në rehabilitimin e tyre, duke punuar me plane individuale si dhe bëheshin përpjekje për t'i përgatitur që të transferoheshin në shtëpizat e mbështetura e në raste shumë të rralla në shtëpi.
- Kjo procedurë kryhej me vendimmarrje të mjekut kurues dhe shefit të pavijonit.
- Kabineti stomatologjik dhe i mikrokirurgjisë kishin nevojë të pajiseshin me autoklavë dhe aerosterilizues.
- Farmacia ishte e pajisur me medikamentet e nevojshme dhe me termometra, doreza dhe maska për shkak edhe të situatës së krijuar të pandemisë kishte pasur një vëmendje të shtuar nga autoritetet e spitalit.
- Nga verifikimi i bërë rezultoi se regjistrat e të gjithë pavijoneve dhe procedurave të shtrimeve që kryhen në këtë spital ishin të sekretuar dhe të mbajtur me rregull, regjistri i pranimit, i konsultave, dhe ai i shtrimeve të pavullnetshme. Të mbajtura me rregull dhe të pasqyruara saktë ishin edhe regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve.



- Ky spital kishte të ngritur sistemin elektronik për çdo pacient dhe diagnozat e tyre si dhe zyrën e informacionit me personel të mjaftueshëm.

Takimet ishin ndaluar të kryheshin në ambientet të brendshme të spitalit, por kur ishte e mundshme pacientët shoqëroheshin në ambientet e oborrit të institucionit nga stafi mjekësor dhe komunikonin në distancë me familjarët, ndërsa në rastet e tjera ata komunikonin në telefon me familjarët e tyre sa herë që e kishin të nevojshme.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, ku parashikohet midis të tjerash se: *“Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca:*

*b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.”.*

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të menjëhershme për t'i dhënë zgjidhje problemit të trajtimit si rezidentë të personave me aftësi të kufizuar intelektuale në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për zgjidhjen e problematikës për plotësimin e strukturës me një mjek psikiatër.
3. Marrjen e menjëhershme të masave për zgjidhjen e përhershme të problematikës në lidhje me plotësimin e vendeve vakante me mjekë, duke gjetur mekanizmat e duhur për mbështetjen dhe stimulimin e kësaj kategorie, për të aplikuar sa herë që është e nevojshme në këto pozicione që janë aq sa të vështira po aq dhe të domosdoshme për mbarëvajtjen e punës në institucionet e shëndetit mendor.
4. Marrjen e masave të menjëhershme lidhur me rikonstruksionin për përmirësimin e kushteve të jetesës në godinën e vjetër, eliminimin e lagështirës në dhoma, dhe zëvendësimin e pajisjeve hidrosanitare dushe e tualete, në mënyrë që të ofrohet një trajtim sa më dinjitoz të personave që trajtohen në këtë spital.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e institucionit me autoklavë për dentistin e institucionit si dhe me aerosterilizues për mikrokirurgjinë.
6. Marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e lagështisë në ambientet e katit të nëndheshëm në godinën e re të Spitalit.
7. Marrjen e masave për plotësimin e të gjitha tualeteve me dushe funksionale si dhe ne veçanti pajisjen e tualetit të tetraplegjikëve me mjetet e nevojshme për funksionimin e tij normal.
8. Marrjen e masave për pajisjen e spitalit me rripa të kufizimit fizik dhe këmisha force si një domosdoshmëri për trajtimin me dinjitet të pacientëve.

9. Marrjen e masave për trajnimin e stafeve mbështetëse për përdorimin e mjeteve fizik konform standardeve të parashikuara në paketën e Akteve Nënligjore të ligjit Nr. 44/2012 "Për Shëndetin Mendor", dhjetor 2013 pika 1.1. si dhe përmirësimin e kushteve aktuale për izolimin e pacientëve me kriza akute.
10. Marrjen e masave për vënien në punë të ashensorit të godinës së re të Spitalit.
11. Marrjen e masave për pajisjen e institucionit me televizorë të rinj.
12. Marrjen e masave për të planifikuar fonde të përshtatshme për rikonstruksion e zëvendësim pajisjesh për shkak të natyrës së personave që qendrojnë në këtë institucion.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, dt. 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONERI**

**Ermonela XHAFJA**